



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5336/prot.

Tiranë, më 29.08.2024

UDHËZIM

Nr. 19; datë 29.08 2024

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, datë 3.5.2024 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT, TË PEZULLIMIT DHE TË LARGIMIT TË MËSUESIT NGA NJË VEND PUNE, SI DHE ADMINISTRIMIT TË PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË” I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 60, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Nina Guga”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:
  - a) Pas pikës 3 të kreut IV, shtohet pika 3/1, si më poshtë:

*“3/1 Kandidatët për për zgjedhjen e vendit të punës paraqiten në ZVAP-in përkatës, sipas njoftimit të KVD-së, në prani të Komisionit Ad-Hoc të ngritur nga ZVAP-ja. Komisioni përbëhet nga Drejtuesi i ZVAP dhe dy anëtarë.”.*
  - b) Në pikën 6 të kreut IV, shkrutimi “DRAP” zëvendësohet me “ZVAP”.
  - c) Në pikën 9 të kreut IV, shkurtimi “DRAP” zëvendësohet me fjalët “ZVAP dhe DRAP”.
  - d) Pas pikës 13 të kreut IV, shtohet pika 13/1 me përmbajtje si më poshtë:

*“13/1 Në rast se për pozicionet e lira në ZVAP nuk paraqiten kandidatë të interesuar për tu punësuar në vendet vakante nga lista e portalit të ZVAP-it dhe DRAP-it përkatës sipas pikës 11 të këtij kreu, atëherë nga ana e ZVAP vijohet me kandidatë të tjerë të interesuar, të cilët kanë paraqitur kërkesë dhe janë renditur sipas pikëve nga ZVAP. Lista e kandidatëve të renditur të kësaj kategorie bëhet publike në faqen elektronike zyrtare të ZVAP dhe dërgohet në DRAP, jo më vonë se tre ditë përpara fillimit të vitit shkollor dhe përditësohet sipas nevojave gjatë vitit shkollor.”.*

- e) Pika 14 e kreut IV, ndryshon si më poshtë:  
*“14. Të gjithë kandidatët e punësuar, sipas pikës 13/1 të këtij kreu në mungesë të kandidatëve nga portali të profilit përkatës, emërohen me kontratë të përkohshme pune, për jo më shumë se një vit shkollor, përfshirë periudhën e nevojshme prej 15 ditësh kalendarike për përfundimin e dokumentacionit shkollor. Kontrata e përkohshme e punës ndërpritet në momentin e emërimit të një kandidati të profilit përkatës nga portali, Për këto raste ZVAP i drejtohet me kërkesë DRAP për miratimin e emërimit të përkohshëm. Këto vende të lira të punës vijojnë të mbeten të publikuara në portal.”*
- f) Pika 11 e kreut V, ndryshohet si më poshtë:  
*“11. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen nga Komisioni Ad-Hoc i ngritur nga ZVAP-ja përkatëse, sipas pikës 3/1, të kreut IV të këtij udhëzimi, për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) dhe më pas atyre të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes së përcaktuar në pikën 10, të këtij kreu. Kandidatët për përzgjedhjen e vendit të punës paraqiten në ZVAP-in përkatës, sipas njoftimit të ZVAP-së.”*
- g) Në pikën 13 të kreut V, fjalët “DRAP-ja njofton” zëvendësohen me fjalët “ZVAP-ja dhe DRAP-ja njoftojnë”.
- h) Pas pikës 5 të kreut VII, shtohet piks 5/1 me përmbajtje si më poshtë:  
*“5/1. Rezultatet e portalit “Mësues për Shqipërinë”, zbatohen sipas këtij udhëzimi deri në momentin që zëvendësohen nga rezultatet e portalit vijues.”*
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

NINA GUGA

